



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në seancën e 51-të, të mbajtur më datë 31.08.2021 morri,

VENDIM

Veprimi i KSHPK-së sipas lëndës së formuar sipas denoncimit me numër 12-1593 / 1 të datës 10.03.2020 të dorëzuar nga parashtrues i njohur-----, që tregon dyshimin për veprime të paligjshme nga një inspektor në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, pas kontrollimit të përmbajtjes së denoncimit dhe dokumentacionit shtesë, përcaktoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme sipas lëndës për arsye se nuk janë përcaktuar pohimet nga denoncimi dhe se ka vepruar dhe marr masa organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12 -1593/1 të datës 10.03.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12 - 1593 të datës 10.03.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtrues i njohur----- .

Në denoncim tregohet dyshim për sjellje të paligjshme nga një inspektor në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit. Përndryshe, në denoncim thuhet se Inspektori Shtetëror i Arsimit ka lëshuar një Njoftim të datës 06.02.2020 me të cilin drejtorit të shkollës fillore ----- atij iu tha se në përzgjedhjen e një mësuesi të edukimit fizik nuk i dha përparësi kandidatit që ka sukses më të lartë gjatë studimeve universitare, me të cilën drejtori ka shkelur nenin 10 paragrafi. 3 të LABP. Duke vepruar kështu, ai lëshoi një masë inspektimi me qëllim që të hiqte shkeljen. Më 18.02.2020 i njëjti inspektor sjell një njoftim ku thuhet se Inspektorati Shtetëror i Arsimit përmes Inspektorit Shtetëror të Arsimit -----, bazuar në nenet

124 dhe 125 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 124/2015) miratoi vendimin nga 18.02.2020 me të cilin akti administrativ Vendimi nga 06.02.2020 shpallet i pavlefshëm. Në vazhdim të denoncimit thuhet se është e paqartë për cilat arsye është miratuar nuliteti i aktit administrativ, dhe njoftimi që e shpall atë si të pavlefshëm është pa shpjegim dhe në kundërshtim me të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore.

Për arsye të verifikimit të pohimevedhe për të vërtetuar plotësisht situatën faktike në rastin e hapur, Komisioni Shtetëror i kërkoi Këshillit të Inspektimit të verifikojë pohimet në denoncim në lidhje me veprimet e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit / inspektorit të treguar në denoncim gjat miratimit të akteve të mësipërme dhe të informojë komisionin shtetëror për situatën e konstatuar. Me kërkesë të Komisionit Shtetëror, një njoftim u mor nga Këshilli i Inspektimit që informonte se në sesionin e tij të rregullt u arrit përfundimi i mëposhtëm: "Nga analiza e përgjithshme e akteve që dalin nga veprimet e inspektorit shtetëror të arsimit -----", pohimet nga parashtrësja / kërkesa nuk janë të bazuara dhe e njëjta konsiderohet si e mbyllur".

Bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, vlerësoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme sipas lëndës në përputhje me nenin 17 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, për arsye se ka vepruar dhe marrë masa organ tjetër kompetent dhe nuk janë vërtetuar pohimet nga denoncimi.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/19), vendosi si në dispozitën të këtij vendimi.

Përgatiti: M.r.B.K.SH, Këshilltar
Miratoi: M.r.SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

KRYETAR
Biljana Ivanovska